



**VENDIM**

**Nr. 125, Datë 29.10.2015**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENSIMIN E  
SHOQËRISË “LE TRADING ALBANIA” SH.P.K. NË  
AKTIVITETIN E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37 pika 2 gërma “ç” dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “f”; 5 pika 1, gërma “f”; 10 pika 3 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 108, datë 09.09.2008 dhe nenit 18 pika 1 gërma “a” e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 21 datë 18.03.2009 të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 29.10.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Le Trading Albania” sh.p.k. si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e furnizimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

**Konstatoi se:**

Aplikimi i shoqërisë “Le Trading Albania” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave” si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e furnizuesit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/9, gërmat “a” dhe “b”); është plotësuar në mënyrë korrekte.

**Për mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:**

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3), (Bilanci financiar i vitit 2014),
- Dokumentacionin teknik për aktivitetin e furnizuesit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/9, germa “c”, kapitali financiar i shoqërisë),

do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë / të Pjesëbëm dhe Rinovimit të Liçensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, ti paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar Bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Fillimin e procedurave për licensimin e shoqërisë “Le Trading Albania” sh.p.k., në aktivitetin e Furnizimit të Energjisë Elektrike.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Liçensuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s**  
**Petrit AHMETI**